

## Zhvillohet Trajnimi "cyber drill", nga ekspertët e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike

Në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", u zhvillua një trajnim praktik të titulluar "cyber drill", nga ekspertët e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike. Ky trajnim u ofroi studentëve të programit të studimit të Teknologji të Informacionit" mundësinë të përballen me skenarë realë të menaxhimit të incidenteve kibernetike.

Përmes këtij simulimi, studentët eksploruan sfidat e sigurisë kibernetike dhe përvetësuan teknika të avancuara për identifikimin dhe zgjidhjen e kërcënimeve.



